

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA*  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

---

**P. nr. 693/12**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – trupit gjykues në përbërje nga Shadije Gërguri si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Mustafë Tahiri anëtarë të trupit gjykues, procesmbajtesin Arianit Mahmutaj ,me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.M.për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose në posedim të pautorizuar nga neni 374 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut – tani themelore në Prishtinë PP.nr. 529-9/2012 të dt.29.07.2012, pas mbajtes së shqyrtimit gjyqësor, me dt: 12.06.2018 në prezencën e prokurorës së shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit N.M.dhe mbrojtësit të tij av.A.B., të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I AKUZUARIT**

**N.M.**nga i ati S. dhe e ema L., i vajzerise T., i lindur me ., në f.sh.”Z.”, tanim e vendbanim në P., rr.J.B”, pa nr. I i martuar, baba 5 femijeve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së e dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Deri me dt:22.07.2012 në shtëpinë e tij në rrugën “J.B.” në P. ka mbajtur në pronësi pistoletën e markës Ekol special- Grizzly me nr. serik EU-1236664 pa leje valide për mbajtjen e autorizuar të saj, e të cilën rreth orës 20:07 në oborrin e shtëpisë së tij me rastin e një ahengu familjar – dasmës së djalit, nga disponimi ka shtënë disa herë në ajër e cila armë pastaj së bashku me karikatorin i’u është sekuestruar nga policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose në posedim të pautorizuar nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,3,7,17, 41,42,45 ,50,51,52,53,62,73,76 të KPRK-së dhe neneve 365 dhe 450 të KPPRK-së,

Të akuzuarit **N.M.**, i shqiptoi **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, në periudhën kohore prej **1 (një) viti**.

Konfiskohet pistoleta e markës Ekol special- Grizzly me nr. serik EU-1236664, e njëjta duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari N.M.obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 € euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Publike e Qarkut – tani themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.nr. 529-9/2012 të dt: 29.07.2012, kundër të akuzuarit N.M.për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose në posedim të pautorizuar nga neni 374 par 1 të KPRK-s KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 12.06.2018 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe pasi I ipet mundësia që të pranojë ose jo fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPK-së ka deklaruar se e pranon fajësinë. Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësit e tij dhe mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit N.M.mori parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë për kryerjen e veprës penale, po ashtu si rrethan lehtësuese ka marrur premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprime inkriminuese dhe moshën e të njëjtit si dhe gjendjen e dobët ekonomike. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbej si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale duke ndikuar kështu në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPK-së.

Vendimin mbi konfiskim, gjykata e mori konform nenit 374par.3 të KPRK-së.  
Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**P nr. 693/12, dt: 12.06.2018**

**Bashkëpunëtor profesional**  
**Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.